



## **Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada-Government*

**Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutrašnjih poslova / Ministry of Internal Affairs**

**Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve**

**2024 – 2028**

**Janar 2024**

<b>1. Përmbledhje ekzeutive:</b> .....	<b>2</b>
1.1 Hyrje.....	3
1.2 Qëllimi.....	4
<b>2 Metodologjia</b> .....	<b>4</b>
<b>4 Sfondi</b> .....	<b>5</b>
<b>5 Korniza ligjore</b> .....	<b>6</b>
<b>6 Mekanizmi institucional</b> .....	<b>6</b>
<b>7 Objektivat e Strategjisë për AVLE</b> .....	<b>9</b>
7.1 Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i mëtutjeshëm i legjislacionit dhe politikave të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e AVLE-ve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse dhe të standardizuar me të gjithë rajonin. ....	10
7.2 Objektivi Strategjik 2: Qasje gjithëpërfshirëse për zvogëlimin e rreziqeve nga AVLE-të që cenojnë sigurinë dhe rendin publik. ....	10
7.3 Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i kapaciteteve institucionale në fushën e AVLE-ve .....	11
7.4 Objektivi Strategjik 4: Të zvogëlohet ndjeshëm numri i përllogaritur i AVLE-ve të poseduara ilegalisht, oferta, kërkesa dhe keqpërdorimi i tyre, përmes rritjes së ndërgjegjësimit, edukimit dhe aktiviteteve të bashkëpunimit. ....	11
7.5 Objektivi Strategjik 5: Reduktimi sistematik i tepricave dhe shkatërrimi i AVLE-ve të konfiskuara, si dhe zvogëlimi i rrezikut të përhapjes dhe devijimit të tyre.....	11
<b>8 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit</b> .....	<b>12</b>
<b>9 Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i Strategjisë:</b> .....	<b>14</b>
<b>10 PLANI I VEPRIMIT</b> .....	<b>14</b>
<b>PLANI I VEPRIMIT TË STRATEGJISË PËR KONTROLLIN E ARMËVE TË VOGLA, TË LEHTA DHE EKSPLOZIVËVE 2024-2026</b> .....	<b>15</b>

## Lista e shkurtesave

1. MPB-Ministria e Punëve të Brendshme;
2. ZKM-Zyra e Kryeministrit;
3. DSP-Departamenti për Siguri Publike;
4. SS – Sekretariati i Strategjive
5. MFPT-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
6. MD- Ministria e Drejtësisë;
7. ANP-Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës;
8. MINT-Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
9. AKI - Agjencia e Kosovës për Inteligjencë;
10. MASHTI -Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
11. MPJD -Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
12. PK- Policia e Kosovës;
13. AKF- Agjencia e Kosovës për Forenzikë;
14. DK - Dogana e Kosovës;
15. KGJK- Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
16. BE- Bashkimi Evropian;
17. OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara;
18. UNDP- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim;
19. OSBE- Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë;
20. KE- Këshilli i Evropës;
21. KPK- Këshilli Prokurorial i Kosovës;
22. KKSBB- Këshillat Komunale të Sigurisë në Bashkësi;
23. PSO- Procedura Standarde e Operimit;
24. AME –Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave;
25. MAPL- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
26. MSH - Ministria e Shëndetësisë;
27. PSH- Prokuroria e Shtetit;
28. SHKK - Shërbimi Korrektues i Kosovës;
29. OJQ - Organizata Joqeveritare;
30. AVL- Armët e Vogla dhe të Lehta;
31. AVLE - Armët e Vogla dhe të Lehta dhe Eksplozivët;
32. PKA/PSHK- Pika e Kontaktit për Armë;
33. DIEKP - Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave;
34. QKMK - Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar;
35. NJPIARK- Njësia e Përbashkët për Inteligjencë, Analizë të Rrezikut dhe Kërcënimeve;
36. GCKD- Grupi për Caktim dhe Koordinim të Detyrave;
37. KPMM- Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale;
38. VKKOR- Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimet e Organizuar dhe të Rënda;
39. DBNP- Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor;
40. SEESAC- Shtëpia e Pastrimit e Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC);
41. SEEFEN- Rrjeti i Evropës Juglindore i Ekspertëve të Armëve të Zjarrit;
42. SEEFEG - Grupi i Evropës Juglindore i Ekspertëve të Armëve të Zjarrit -Përmbledhje Ekzekutive;
43. ISACS –Standardi Ndërkombëtar për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta;
44. Analiza PESTEL-analiza e ndikimeve politike, ekonomike, sociale, teknologjike, mjedisore dhe ligjore;
45. FSB- Formuni i Sigurisë në Bashkësi;

46. EXBS- Programi i Kontrollit të Eksportit dhe Ndihmës për Sigurinë Kufitare së SHBA-së;
47. MOSAIC - Modul Përmbledhës për Zbatimin e Kontrollit të Armëve të Vogla;
48. SERA – Sistemi Elektronik për Regjistrimin e Armëve;
49. EXPLOCON- Sistemi Elektronik për Kontrollin e Eksplozivëve dhe Fishezkjarreve.

## **1. Përmbledhje ekzekutive:**

Strategjia Kombëtare për AVLE është dokument strategjik i cili përcakton politikat dhe masat që duhet të ndërmerren kundër keqpërdorimit të AVLE. Kjo Strategji dhe Plan i Veprimit, reflektojnë prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për luftimin dhe parandalimin e të gjitha formave të keqpërdorimit të armëve, përmes mekanizmave institucional. Kjo Strategji, gjithashtu reflekton zotimet e Qeverisë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe obligimet që rrjedhin nga procesi i integritetit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, respektivisht për zbatimin e obligimeve që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Objektivat strategjik dhe ata specifik, janë përcaktuar pas një procesi të konsultimit me të gjithë akterët e brendshëm institucional, si dhe me akterët e tjerë të jashtëm, si shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Strategjia gjithashtu është bazuar në analizat paraprake të realizuara në bashkëpunim me partnerët vendor dhe ndërkombëtar, në veçanti, në vlerësimin e zbatimit të Strategjisë, të Planit të Veprimit 2017-2020, raporteve të punës dhe rekomandimet e dala nga ky vlerësim. Gjithashtu, Strategjia është hartuar në bazë të vlerësimit afatmesëm të Udhërefyesit Rajonal për Kontrollin e AVLE-ve për periudhën 2018- 2022.

Ky dokument strategjik ndahet në dy pjesë: Strategjia për AVLE dhe Plan i Veprimit, i cili përmban objektivat strategjik, ata specifik, si dhe aktivitetet të cilat planifikohen të përmbushen në periudhën trevjeçare 2024-2026. Objektivat strategjik dhe specifik, si dhe aktivitetet, janë të paraqitura në detaje në Planin e Veprimit, i cili po ashtu përmban pjesën buxhetore, indikator të matshëm dhe konkret, si dhe përshkruan në detaje institucionet përgjegjëse dhe rolin e tyre në luftimin dhe parandalimin e keqpërdorimit AVLE.

Pjesë të rëndësishme të Strategjisë përmbajnë edhe llogaritjet e ndikimeve financiare të cilat janë diskutuar me grupin punues dhe janë reflektuar me secilin institucion përkatës. Në Strategjinë për AVLE, 2024-2028 rekomandohen veprime dhe masa konkrete me qëllim të adresimit të sfidave të identifikuar dhe përmirësimit të gjendjes në parandalimin dhe luftimin efikas të keqpërdorimit të armëve.

Në këtë drejtim janë paraparë veprime në funksion të përmirësimit të mekanizmit shtetëror, të zbatimit të veprimeve të koordinuara drejt parandalimit dhe vetëdijesimit për pasojat e keqpërdorimit të armëve, ngritjes së efikasitetit në ndjekjen penale të keqpërdoruesve të armëve, si dhe fuqizimit të bashkëpunimit regional dhe ndërkombëtar. Të gjitha këto veprime janë rekomanduar si rezultat i vlerësimit të situatës aktuale në vend dhe në kontekst rajonal e global në raport me përdorimin e armëve.

Rrjedhimisht, adresimi i veprimeve të rekomanduara pritet të ketë ndikim pozitiv në adresimin e boshllëqeve të identifikuar në sistem, duke mundësuar njëkohësisht avancimin dhe fuqizimin e parandalimit dhe luftimit të keqpërdorimit të armëve. Plan i Veprimit është hartuar në përputhje me objektivat strategjik, objektivat specifik dhe aktivitetet e planifikuara që do të ndihmojnë në përmbushjen e objektivave specifik drejt arritjes së objektivave strategjik.

### **1.1 Hyrje**

Qeveria e Republikës së Kosovës, është e vëmendshme dhe e vetëdijshme për dukuritë e keqpërdorimit të AVLE, si dukuri vendore dhe ndërkombëtare, që në mënyrë direkte dhe indirekte, paraqet rrezik edhe për vendin tonë. Duke filluar nga ky vlerësim, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka hartuar dhe miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për luftimin dhe parandalimin e përdorimit të armëve të lehta dhe eksplozivëve.

Qeveria dhe mekanizmat e saj si, sektori i drejtësisë dhe sigurisë, në bashkëpunim dhe koordinim me subjektet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me shoqërinë civile, në kontinuitet dhe intesivisht ka dhënë mbështetjen, përmbajtjen dhe me pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë në luftimin dhe parandalimin e këtyre dukurive përmes zbatimit të Planit të Veprimit të kësaj Strategjie.

Këto aktivitete dhe angazhime, janë vlerësuar pozitivisht edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, 2021- 2022.

Megjithatë, aktualizimi dhe përditësimi i dokumenteve strategjike në këtë sferë të punës dhe aktivitetit, duhet të jetë edhe më intensive dhe në kontinuitet tek të gjitha subjektet vendore dhe ndërkombëtare, shoqërinë civile etj, sepse praktika tragon se ende ka mbetur hapësirë për angazhime dhe veprime në zbatimin e dokumenteve strategjike të sipërpërmendura. Kjo për arsye dhe shkaqe se, keqpërdorimi me armë është dukuri komplekse dhe shumë dimensionale, problem shoqëror vendor dhe rajonal dhe më gjerë.

Pasojat që dalin nga efektet e drejtëpërdrejta dhe të tërthorta nga kjo dukuri, janë shumëfish të dëmshme për shoqërinë, familjen dhe vet shtetin. Njëkohësisht mosluftimi efikas i kësaj dukurie, ndikon negativisht në rrezikimin e sigurisë publike, shtetërore, regjionale dhe më gjerë. Ky dokument strategjik është hartuar specifikisht me qëllime, synime, objektiva dhe metoda të veprimit. Ky dokument i strukturuar do të ndihmojë dhe ndikojë në parandalimin dhe luftimin e keqpërdorimit të AVLE, në anën tjetër, do të ndikojë në ngritjen e vetëdijes, ndërgjegjes qytetare dhe shoqërisë në tërësi. Do të mundësojë krijimin e një ambienti të mirë dhe më të sigurt dhe zhvillim të përgjithshëm shoqëror, ekonomik, arsimor, shëndetësor dhe të ngjashme.

## 1.2 Qëllimi

Ky dokument strategjik ka për qëllim të përcaktoj, të promovoj orientim të përgjithshëm dhe specifik për institucionet dhe agjencitë të cilat realizojnë objektiva, zbatojnë aktivitete të sigurisë në Republikën e Kosovës. Për më tepër, ky dokument paraqet qëllimin e Qeverisë dhe subjekteve shoqërore të Kosovës për kontrollin e armëve, municionit dhe eksplozivëve dhe planin specifik të veprimit.

Republika e Kosovës është zotuar të promovoj stabilitetin dhe sigurinë, jo vetëm brenda vendit, por të jetë edhe kontribuese dhe koordinuese e rëndësishme ndaj sigurisë së vendit, rajonit dhe më gjerë.

Kështu bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e kontrollit dhe luftës kundër trafikimit të paligjshëm të AVL dhe eksplozivëve, mbetet një nga qëllimet e Qeverisë, përkatësisht të organeve të drejtësisë, sigurisë, shoqërisë civile etj.

## 2 Metodologjia

Metodologjia e hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për kontrollin e AVLE është bërë duke u mbështetur në metodat e vlerësimit dhe analizat e institucioneve të specializuara, të dhënave statistikore nga institucionet vendore dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare.

Në anën tjetër është mbështetur në kërkesat e Bashkimit Evropian të cilat burojnë nga Plani i Veprimit të BE-së kundër Trafikimit dhe Përdorimit të Armëve të Zjarrit dhe Eksplozivëve<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> <https://www.europarl.europa.eu/legislative-train/carriage/action-plan-on-firearms-trafficking/report?sid=7201>

Me vendimin nr.1140/2023 të datës 26/06/2023, ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka themeluar Ekipin Punues për hartimin e Strategjisë për AVLE dhe Planin e Veprimit. Në përbërje të Ekipit Punues kanë marrë pjesë përfaqësues nga institucionet publike, ekspertët ndërkombëtarë, dhe organizatat partnere ndërkombëtare. Ekipi Punues ka për detyrë hartimin e Strategjisë për AVLE dhe Planin e Veprimit në nivel shtetëror.

Metodologjia e punës në këtë Strategji gjithashtu është bazuar në praktikat dhe standardet tjera ndërkombëtare MOSAIC, duke synuar të jetë në harmoni me standardet dhe rregulloret e BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Janë mbajtur punëtori për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit në këtë fushë të sipërtheksuar, natyrisht duke u mbështetur nga Projekti SEESAC /UNDP.

Të gjithë përfaqësuesit e subjekteve përgjegjëse kanë pasur qasje dhe mundësi që të ofrojnë propozimet, sygjerimet, vlerësimet e tyre dhe të diskutojnë mbi to, pra mbi objektivat dhe aktivitetet e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

Këto dokumente strategjike janë plotësisht të koordinuara me Udhërrëfyesin për Kontrollin e AVLE në Ballkanin Perëndimor, duke u bazuar edhe në standardet evropiane.

## 4 Sfondi

Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për menaxhimin, kontrollin e AVLE-ve dhe luftën kundër trafikimit të tyre. Këtë më së miri e tregon përmes veprimeve konkrete duke qenë pjesëmarrëse direkte e të gjitha iniciativave rajonale në luftimin e AVLE-ve të paligjshme, duke përafuar legjislationin e saj me atë të BE-së.

Republika e Kosovës është në proces të plotësim-ndryshimeve të Ligjit për Armë dhe atij për Eksplozivë. Gjatë vitit 2024, do të punohet në hartimin e tyre dhe ato do të harmonizohen me aktet ligjore të BE-së, për të cilat vendi ynë është zotuar se do t'i harmonizoj.

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Armë, qytetarët e Republikës së Kosovës, nga viti në vit, janë duke u vetëdijësuar dhe me vullnet të plotë janë drejtuar në posedimin e ligjshëm të armëve dhe ka rënë vullneti dhe dëshira në posedimin e paligjshëm të armëve të ndryshme<sup>2</sup>.

Duke pasur parasysh se shteti ynë ka krijuar kushte të volitshme të bërit biznes edhe në fushën e tregtimit me armë, municion dhe eksplozivë, prej vitit në vit është shfaqur ngritje në performancën biznese, por mbi të gjitha, në krijimin e një ambineti të sigurt për të gjithë qytetarët në të gjithë territorin e Kosovës.

Situata aktuale legjislative është brenda suazave, por kemi direktiva të reja që janë miratuar pas hyrjes në fuqi të ligjeve përkatëse dhe tanimë nevojitet riharmonizimi me Acquis të BE-së dhe me legjislationet vendore, në bazë të këtyre, nevojitet ndryshimi dhe plotësimi i tyre.

Gjithashtu, bashkëpunimi institucional vendor, por edhe ai ndërkombëtar është në nivelin e duhur dhe këtu duhet shtuar faktin se Republika e Kosovës merr pjesë në të gjitha aktivitetet e

---

<sup>2</sup> Small Arms Survey (2014), page 5 - <http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/G-Issuebriefs/SAS-AV-IB4-Western-Balkans.pdf>

organizuar nga mekanizmat ndërkombëtarë, ku edhe është zotuar se do të zbatohet në përpikëri Udhërrëfyesin Rajonal<sup>3</sup>, i dalë nga nisma e Berlinit për vendet e Ballkanit Perëndimor për luftimin dhe keqpërdorimin e AVLE-ve dhe i rikonfirmuar gjatë takimit ministror të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, më 16 maj 2023 për vazhdimin e zbatimit të fazës së dytë të Udhërrëfyesit.

Përvojat e deritanishme na kanë mësuar se këto procese janë lëvizëse dhe se veprimet tona gjithnjë duhet të jenë në harmoni me aspiratat e anëtarësimit në BE dhe NATO, duke i përcjellë me vëmendje ndryshimet në direktivat dhe rregulloret e BE-së.

## 5 Korniza ligjore

Në fushën e kontrollit të AVLE-ve Republika e Kosovës ka në zbatim një bazë të gjerë ligjore, e cila përfshin, por nuk kufizohet vetëm me:

1. Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
2. Ligjin për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
3. Ligjin për Armë;
4. Ligjin për Gjuetinë;
5. Ligjin për Përdorimin Civil të Eksplozivëve;
6. Ligjin për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri;
7. Ligjin për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive;
8. Ligjin për Tregtinë e Mallrave Strategjike;
9. Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
10. Ligjin për Policinë;
11. Ligjin për Rendin dhe Qetësinë Publike;
12. Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë;
13. Ligjin për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare;
14. Ligjin për Ndihmën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale;
15. Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare;
16. Ligjin për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror;
17. Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë;
18. Ligjin për Tregtinë e Mallrave Strategjike;
19. Ligjin për Shërbimet Private të Sigurisë;
20. Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
21. Ligjin për Ndryshim-Plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë;
22. Ligjin për Mbrojtjen e Informacioneve të Klasifikuara;
23. Kodin Penal të Republikës së Kosovës;
24. Kodin e Procedurës Penale;
25. Kodin Doganor dhe i Akcizave të Kosovës.

## 6 Mekanizmi institucional

Mekanizmi institucional nënkupton të gjithë mekanizmat, të cilët kanë rol dhe rëndësi primare dhe sekondare në zbatimin e Strategjisë. Mekanizmat institucional për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë janë evidentuar si më poshtë, por nuk kufizohen në:

<sup>3</sup> [https://www.seesac.org/fi/docs/publications-salw-control-roadmap/Roadmap\\_brosura\\_20x20\\_ALB\\_web.pdf](https://www.seesac.org/fi/docs/publications-salw-control-roadmap/Roadmap_brosura_20x20_ALB_web.pdf)

## **Koordinatori Nacional për Kontrollin e AVLE-ve**

Koordinatori Nacional është ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, ose njëri nga zëvendësministrat, të cilit ia delegon përgjegjësinë, të bashkërendojë, udhëzojë, monitorojë dhe të raportojë për zbatimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve në lidhje me Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Kontrollin e AVLE-ve.

## **Sekretariati i Strategjive**

Sekretariati i Strategjive në MPB ka për detyrë të monitorojë në baza të rregullta zbatimin e Strategjisë, duke mbledhur dhe analizuar të dhëna rreth zbatimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit, si dhe duke hartuar raportet periodike dhe vlerësuese për Koordinatorin Nacional. Përveç këtyre, sekretariati do të ndihmojë Koordinatorin Nacional për koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë dhe komunikimin me palët e interesit.

## **Departamenti për Siguri Publike - Ministria e Punëve të Brendshme**

DSP është përgjegjëse për propozimin, hartimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e armëve dhe eksplozivëve. DSP menaxhon me bazat e të dhënave SERA dhe EXPLOCON, si dhe kryeson me Komisionin Nacional për shqyrtimin e aplikimeve për tregtimin, eksportin dhe aplikimet/kërkesat relevante për leje dhe licencime, të cilat dalin nga Ligji për Armë dhe Ligji për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri.

## **Policia e Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme**

Policia e Kosovës është agjenci e cila funksionin në kuadër të MPB-së dhe është insitucioni kryesor i ngarkuar në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve. Në bashkëpunim me institucione tjera ligj-zbatuese për parandalimin dhe zbulimin e trafikimit në kufi dhe brenda territorit të vendit.

## **Pika e Kontaktit për Armë (PKA)/Policia e Kosovës**

Pika e Kontaktit për Armë (PKA), ka për funksion grumbullimin e informatave dhe të dhënave statistikore nga institucionet relevante, analizimin dhe vlerësimin e të dhënave të mbledhura, si dhe hartimin dhe shpërndarjen e raporteve analitike për organet relevante dhe për Koordinatorin Nacional. Pika e Kontaktit për Armë (PKA) shërben edhe si Pikë e Përherhme e Kontaktit 24/7 për bashkëpunim ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit.

## **Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar (QKMK)**

Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar (QKMK) është mekanizëm i vendosur në MPB, e cila ka për funksion bashkërendimin e aktiviteteve dhe operacioneve 24/7 që dalin nga kërkesat e autoriteteve të përfshira në MIK dhe ndërlidhjen me autoritetet tjera të zbatimit të ligjit sipas nevojës, duke ofruar mbështetje, lehtësuar shkëmbimin e informatave dhe rritjen e integritit në mes të autoriteteve të përfshira në fushën e menaxhimit të kufirit shtetëror dhe atyre të zbatimit të ligjit.

Njësia e Përbashkët për Inteligjencë, Analizë të Rrezikut dhe Kërcënimeve (NJPIARK) - vepron në kuadër të QKMK e cila do të ketë për detyrë të ofrojë të dhëna inteligjence, të analizuar për



sektorët e nivelit taktik, operacional dhe nivelit strategjik. Po ashtu, në këtë pjesë është edhe Grupi për Caktim dhe Koordinim të Detyrave (GCKD), i cili do të marrë përsipër ndërlidhjen e strategjive mes MIK dhe AVL.

### **Agjencia e Kosovës për Forenzikë**

AKF mbështet zyrat e Prokurorive dhe Ministrinë për Punë të Brendshme në përputhje me legjislacionin relevant. Përveç kësaj, AKF prodhon inteligjencën balistike për armët e zjarrit dhe municionin.

### **Prokurori i Shtetit**

Është institucion përgjegjës për ndjekjen penale të veprave penale në përgjithësi dhe në veçanti për veprat penale që kanë të bëjnë me AVLE-të.

### **Gjykata**

Gjykata është institucion përgjegjës për ndëshkimin e kryrseve të veprave penale, për konfiskimin e pasurisë dhe aseteve të fituara me anë të aktiviteteve kriminale.

### **Këshilli Prokurorial**

Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional dhe i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës, përfshirë dhe parimet e pranura ndërkombëtare të barazisë gjinore.

### **Këshilli Gjyqësor**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij.

### **Agjencia e Kosovës për Inteligjencë**

AKI bën identifikimin e kërcënimeve që rrezikojnë sigurinë e Kosovës. Kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës konsiderohet kërcënim ndaj integritetit territorial, integritetit të institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik. Pjesë e mandatit të AKI është edhe lufta kundër trafikimit të armëve.

### **Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale**

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale do të bashkëpunojë me MPB-në për zbatim adekuat të Ligjit për Përdorim Civil të Eksplozivëve.

### **Zyra e Kyeministrit**

Harmonizimin me legjislacionin dhe politikave të BE-së e bën Zyra e Kyeministrit, konkretisht Departamenti për të Drejtën e BE-së.

### **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Departamentin e Sigurisë Publike dhe Policinë e Kosovës, kontrollon kompanitë e përfshira në tregtinë me AVL dhe licencimin dhe mbikëqyrjen e kompanive për përdorimin e mallrave të dyfishtë.

### **Ministria e Drejtësisë**

MD përgatit dhe zhvillon legjislacionin në fushën e drejtësisë, veçanërisht tek Kodi Penal, si dhe koordinon dhe zhvillon bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

### **Ministria e Mbrojtjes**

MM ka rolin e deminimit të eksplozivëve kur kemi situata të raportimeve për gjetje ose kur qytetarët dorëzojnë vullnetarisht eksplozivë të ndryshëm. Gjithashtu, ka rolin në lëshimin e pëlqimit për licencimin e kompanive që merren me PQV.

### **Ministria e Financave**

MF siguron që kostot financiare të aktiviteteve të Strategjisë janë brenda kornizave buxhetore. Gjithashtu, përmes Doganës, Njësisë së Inteligjencës Financiare dhe Administratës Tatimore, do të ndihmojë në forcimin e sigurisë së brendshme, parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm.

### **Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

MASHT luan rol të rëndësishëm në fushën e parandalimit dhe vetëdijesimit nëpërmjet hartimit të kurrikulave, organizimit të aktiviteteve vetëdijesuese dhe aktiviteteve tjera jashtë-programore.

### **Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës**

MPJD ka rol në drejtim të dhënies së ndihmës për bashkëpunim ndërkombëtar dhe të pjesëmarrjes në organizata rajonale dhe ndërkombëtare. Në bashkëpunim me MPB-në do të sigurojë zbatimin adekuat të embargove dhe Kodit Evropian të mirësjelljes të eksportit të armëve. MPJD do të jetë organ ekzekutiv për miratimin dhe lëshimin e raporteve të rregullta të progresit të Kosovës për organizatat relevante ndërkombëtare për kontrollin e AVL.

## **7 Objektivat e Strategjisë për AVLE**

Duke u bazuar në efikasitetin dhe rezultatet nga strategjitë paraprake edhe më tutje, aktivitetet e institucioneve të Republikës së Kosovës në parandalimin e keqpërdorimit të AVLE-ve janë të orientuara në pesë (5) objektiva strategjikë:

**Objektivi Strategjik 1:** Zhvillimi i mëtutjeshëm i legjislacionit dhe politikave të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e AVLE-ve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse i standardizuar me rajonin.

**Objektivi Strategjik 2:** Qasje gjithëpërfshirëse për zvogëlimin e rreziqeve nga AVLE-të që cenojnë sigurinë dhe rendin publik.

**Objektivi Strategjik 3:** Zhvillimi i kapaciteteve institucionale në fushën e AVLE-ve.

**Objektivi Strategjik 4:** Të zvogëlohet ndjeshëm numri i përllogaritur i AVLE-ve të poseduara ilegalisht, oferta, kërkesa dhe keqpërdorimi i tyre, përmes rritjes së ndërgjegjësimit, edukimit dhe aktiviteteve të bashkëpunimit.

**Objektivi Strategjik 5:** Reduktimi sistematik i tepricave dhe shkatërrimi i AVLE-ve të konfiskuara, si dhe zvogëlimi i rrezikut të përhapjes dhe devijimit të tyre.

**7.1 Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i mëtutjeshëm i legjislacionit dhe politikave të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e AVLE-ve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse dhe të standardizuar me të gjithë rajonin.**

**Ka këto objektiva specifike:**

- **Objektivi specifik 1.1:** Të miratohen ligjet dhe akte nënligjore lidhur me AVL-të për përdorim civil (duke përfshirë ato mbi posedimin e ligjshëm, çaktivizimin, ruajtjen, prodhimin, shitjen me pakicë, tregtimin, transportin, import-eksportin, shënjimin, armët e konvertueshme, gjurmimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen) dhe ato të harmonizohen me kuadrin ligjor të OKB-së dhe BE-së;
- **Objektivi specifik 1.2:** Të miratohet kuadri ligjor lidhur me AVL-të për përdorim ushtarak (duke përfshirë ato për çaktivizimin, ruajtjen, prodhimin, shitjen me pakicë, tregtimin, transitin, import-eksportin, shënjimin, gjurmimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen) dhe ato të harmonizohen me kuadrin ligjor të OKB-së dhe BE-së;
- **Objektivi specifik 1.3.:** Të miratohet kuadri ligjor lidhur me përdorimin civil të eksplozivëve (duke përfshirë ato për ruajtjen, prodhimin, shitjen me pakicë, tregtimin, transitin, transportin, import-eksportin, shënjimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen, e shkatërrimin);
- **Objektivi specifik 1.4:** Të garantohet përputhshmëria e kornizës ligjore për kontrollin e AVLE-ve me vendet e Ballkanin Perëndimor, gjë që garanton bashkëpunimin operacional të drejtpërdrejtë, me të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor;
- **Objektivi specifik 1.5:** Të miratohen standardet dhe praktiket më të mira ndërkombëtare në fushën e kontrollit të AVLE dhe në hetimet që lidhen me krimet me AVLE;
- **Objektivi specifik 1.6:** Hartimi i ligjit dhe akteve nënligjore lidhur me prekursorët për eksplozivë të harmonizuara me kuadrin ligjor dhe BE-së.

**7.2 Objektivi Strategjik 2: Qasje gjithëpërfshirëse për zvogëlimin e rreziqeve nga AVLE-të që cenojnë sigurinë dhe rendin publik.**

**Ka këto objektiva specifike:**

- **Objektivi specifik 2.1:** Të fuqizohet një sistem për mbledhjen e të dhënave në të gjitha institucionet përkatëse lidhur me shpërndarjen dhe ndikimin e AVLE-ve, me të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe moshës;
- **Objektivi specifik 2.2:** Të fuqizohen kapacitetet e PKA/PK-së për të ofruar mbështetje në parandalimin, zbutjen, reagimin dhe eliminimin e keqpërdorimit, trafikimit dhe përhapjes së paligjshme të AVLE-ve;
- **Objektivi specifik 2.3:** Të sigurohet shkëmbimi i informacionit operacional dhe strategjik i të dhënave, i informacionit të inteligjencës, si dhe provave që ndërlidhen me AVLE-ve me Europol, Interpol, Frontex dhe Eurojust;

- **Objektivi specifik 2.4:** Të fuqizohet roli i autoritetit të AVLE-së në koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të planit kombëtar të veprimit të kësaj Strategjie;
- **Objektivi specifik 2.5:** Të përmirësohet reagimi nga institucionet e Drejtësisë Penale përmes rekomandimeve nga autoriteti për AVLE lidhur me keqpërdorimin, zotërimin e paligjshëm dhe trafikimin e AVLE-ve;
- **Objektivi specifik 2.6:** Të avancohen kapacitetet institucionale dhe aftësitë për të shënjuar, gjurmuar dhe mbajtur të dhëna për AVLE-të;
- **Objektivi specifik 2.7:** Të rritet pjesëmarrja e grave dhe të rinjve në fushën e kontrollit të AVLE-ve;
- **Objektivi specifik 2.8:** Të përmirësohet përgjigjja institucionale dhe e politikës ndaj keqpërdorimit të AVLE-ve në dhunën në familje.

### 7.3 Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i kapaciteteve institucionale në fushën e AVLE-ve

Ka këto objektiva specifike:

- **Objektivi specifik 3.1:** Të rriten kapacitetet për mbledhjen dhe analizën e të dhënave për të përmirësuar zbulimin, identifikimin dhe hetimin e AVLE;
- **Objektivi specifik 3.2:** Të rritet kapaciteti i sistemit të drejtësisë penale për të ndjekur penalisht dhe dënuar krimet e lidhura me AVLE;
- **Objektivi specifik 3.3:** Të forcohen kapacitetet e kontrollit të importit/eksportit të AVLE, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut, licencimin, dërgimin dhe verifikimin pas dërgimit;
- **Objektivi specifik 3.4:** Të forcohet kontrolli dhe monitorimi i shitjes dhe transferimit të prekursorëve për eksplozivë;
- **Objektivi specifik 3.5:** Të përmirësohen dhe avancohen praktikatat e mira për të luftuar keqpërdorimin e AVLE-ve.

### 7.4 Objektivi Strategjik 4: Të zvogëlohet ndjeshëm numri i përlogaritur i AVLE-ve të poseduara ilegalisht, oferta, kërkesa dhe keqpërdorimi i tyre, përmes rritjes së ndërgjegjësimit, edukimit dhe aktiviteteve të bashkëpunimit.

Ka këto objektiva specifike:

- **Objektivi specifik 4.1:** Të rritet ndërgjegjësimi i subjekteve të licencuara private dhe juridike për rrezikun e keqpërdorimit dhe përhapjes së paligjshme të AVLE-ve;
- **Objektivi specifik 4.2:** Të rritet ndërgjegjësimi i rrezikut të devijimit për prodhuesit e AVLE-ve;
- **Objektivi specifik 4.3:** Të rritet niveli i ndërgjegjësimit dhe njohurive të shoqërisë civile për keqpërdorimin dhe mbajtjen pa leje të AVLE-ve;
- **Objektivi specifik 4.4:** Të rritet ndërgjegjësimi dhe roli i medias për rëndësinë e raportimit të përshtatshëm për keqpërdorimin e AVLE-të dhe dhunës së shkaktuar;
- **Objektivi specifik 4.5:** Hartimi i planit medial për raportim për AVLE;
- **Objektivi specifik 4.6:** Të rritet besimi i publikut në institucionet e sigurisë;
- **Objektivi specifik 4.7:** Të rriten kapacitetet e komunikimit dhe informimit të institucioneve publike të sigurisë;
- **Objektivi specifik 4.8:** Të përmirësohet përgjigjja institucionale dhe e politikës ndaj keqpërdorimit të AVLE-ve në dhunën në familje.

### 7.5 Objektivi Strategjik 5: Reduktimi sistematik i tepricave dhe shkatërrimi i AVLE-ve të konfiskuara, si dhe zvogëlimi i rrezikut të përhapjes dhe devijimit të tyre.

Ka këto objektiva specifike:

- **Objektivi specifik 5.1:** Të kryhet shkatërrimi i AVLE-ve të konfiskuara në mënyrë periodike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- **Objektivi specifik 5.2:** Të zhvillohen sistemet qendrore të inspektimit të forcave të armatosura në përputhje me IATG/NATO;
- **Objektivi specifik 5.3:** Të sigurohet që mjediset e depove për AVLE të janë të sigurta, sipas standardeve ndërkombëtare;
- **Objektivi specifik 5.4:** Të sigurohet që organet mbikëqyrëse kanë kapacitetet e duhura njerëzore dhe teknike për të monitoruar, mbikëqyrur dhe vlerësuar sigurinë fizike dhe menaxhimin e depove të subjekteve juridike të licencuara dhe të individëve;
- **Objektivi specifik 5.5** Të analizohet çështja e devijimit të mundshëm lidhur AVLE-të, në mënyrë periodike.

## 8 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit

Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse kryesore e zbatimit të Strategjisë për AVLE, institucionet tjera përkatëse janë të obliguara për zbatim dhe raportim të objektivave të parapara në Plan të Veprimit. Po ashtu, MPB ndërmer veprime, nëse është e nevojshme, për të siguruar zbatimin në kohë dhe në mënyrë efektive të aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit të Strategjisë, do të angazhohet Sekretariati për Strategji në kuadër të MPB-së<sup>4</sup>, i cili do të përgatisë:

- **Raporte gjashtë (6) -mujore** për arritjen e objektivave strategjike dhe për zbatimin e Planit të Veprimit. Raporti gjashtë (6) mujor do të përmbajë informata për arritjen e objektivave dhe zbatimin e aktiviteteve. Në kuadër të raportit gjashtë (6) mujor, në veçanti do të nënvizohen vështirësitë e hasura, sfidat, rreziqet e identifikuar dhe adresimi i tyre për zbatimin e Strategjisë;
- **Raporte vjetore** për arritjen e objektivave strategjike dhe për zbatimin e Planit të Veprimit. Raporti vjetor i progresit do të përmbajë informata për arritjen e objektivave dhe zbatimin e aktiviteteve. Në kuadër të raportit vjetor, në veçanti do të nënvizohen vështirësitë e hasura, sfidat, rreziqet e identifikuar dhe adresimi i tyre për zbatimin e strategjisë, si dhe përcjellja e indikatorëve matës dhe zbatimi i tyre.

**Plani vjetor** do të rishikohet sipas shkallës së zbatimit/mos-zbatimit të aktiviteteve të parapara në Strategji.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Armët e Vogla, të Lehta dhe Eksplozivë 2024-2028, janë:

- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Departamenti për Siguri Publike;
- Policia e Kosovës;
- Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- Ministria e Drejtësisë;

---

<sup>4</sup> Sekretariati i Strategjive / Zyra e Koordinatorit Kombëtar: Sekretariati i Strategjive në MPB ka për detyrë të monitorojë në baza të rregullta zbatimin e Strategjisë duke mbledhur dhe analizuar të dhëna rreth zbatimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit, si dhe duke hartuar raportet periodike dhe vlerësuese për Koordinatorin Kombëtar. Përveç këtyre, Sekretariati do të ndihmojë Koordinatorin Kombëtar për koordinim e implementimit të Strategjisë dhe komunikimin me palët e interesit.

- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar; Agjencia për Barazi Gjinore;
- Prokurori i Shtetit;
- Gjykatat;
- Komunitat, dhe
- Çdo ofrues i shërbimeve në kuadër të këtyre institucioneve që merret me Armët e Vogla, të Lehta dhe Eksplozivë.

Mekanismi i monitorimit do të funksionojë në përputhje me parimet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në Doracakun për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Tyre të Veprimit.

Autoriteti përgjegjës për përgatitjen e raporteve sipas mandatit është Sekretariati për Monitorim dhe Evaluim të Strategjive Nacionale, përkrahur nga Koordinatorit Kombëtar për AVLE në kuadër të MPB-së.

Raportet e progresit që do të përgatiten:

- Raporti gjashtë (6) mujor i zbatimit;
- Raporti vjetor i zbatimit;
- Raporti përfundimtar.

	Autoriteti përgjegjës për hartimin e raportit	Afati i fundit	Finalizimi i raportit
Raporti 6-mujor mbi zbatimin	Sekretariati për Monitorim dhe Evaluim të Strategjive Nacionale në përkrahjen e Koordinatorit Kombëtar		AKAT
Raporti vjetor i zbatimit	Sekretariati për Monitorim dhe Evaluim të Strategjive Nacionale në përkrahjen e Koordinatorit Kombëtar		Nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm (MPB)

Raporti përfundimtar	Sekretariati për Monitorim dhe Evaluim të Strategjive Nacionale në përkrahjen e Koordinatorit Kombëtar		Nënshkruar nga Ministri i Punëve të Brendshme
----------------------	--	--	---

Në rast të ndonjë problemi të theksuar gjatë implementimit ose në rast të rrethanave të ndryshuara, ministria përgjegjëse e informon Zyrën për Planifikim Strategjik ( në tesktin e mëtejme; ZPS) në kohën e duhur. Ministria përgjegjëse dhe ZPS, pas vlerësimit të situatës së përbashkët, do të propozojnë veprimin e nevojshëm për Komisionin e Planifikimit Strategjik.

## 9 Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i Strategjisë:

Për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për tri vitet e para do të nevojiten burimet e paraqitura në planin e mësipërm në vlerë monetare EURO.

## 10 PLANI I VEPRIMIT

Plani i Veprimit reflekton përputhshmërinë e tij me kornizën e përgjithshme të Strategjisë Kombëtare për AVLE.

Plani i Veprimit do të rishikohet në fillim të çdo viti, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i Strategjisë dhe harmonizimi me trendet vendore dhe ndërkombëtare.

Plani i Veprimit për zbatimin e kësaj Strategjie përfshin:

- Objektivat strategjikë;
- Objektivat specifikë;
- Aktivitetet konkrete për zbatim;
- Përcaktimin e institucioneve përgjegjëse dhe përkrahëse për përmbushjen e secilit objektiv;
- Specifikimin e kornizës kohore për përmbushjen e secilit aktivitet;
- Përcaktimin e burimeve të nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve, dhe
- Përcaktimin e indikatorëve për zbatimin e secilit objektiv dhe aktivitet.

**PLANI I VEPRIMIT TË STRATEGJISË PËR KONTROLLIN E ARMËVE TË VOGLA, TË LEHTA DHE EKSPLOZIVËVE 2024-2026**

<b>STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR KONTROLLIN E ARMËVE TË VOGLA, TË LEHTA DHE EKSPLOZIVËVE 2024-2026</b>								
<b>Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i mëtutjeshëm i legjislacionit dhe politikave të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e AVLE-ve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare dhe i standardizuar me rajonin</b>								
<b>Objektivi specifik 1.1</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>	<b>Baza</b>	<b>Caku 2025</b>	<b>Caku 2026</b>				
Të miratohen ligjet dhe aktet nënligjore lidhur me AVL-të për përdorim civil (duke përfshirë ato mbi posedimin e ligjshëm, çaktivizimin, ruajtjen, prodhimin, shitjen me pakicë, tregtimin, transportin, import-eksportin, shënjimin, armët e konvertueshme, gjurmimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen), dhe ato të harmonizohen me kuadrin ligjor të OKB-së dhe BE-së.	Numri i dokumenteve ligjore për kontrollin e AVL-së të harmonizuar me legjislacionin e BE-së, Traktatin për Tregtinë e Armëve dhe Protokollin e OKB-së kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Komponentëve dhe Municioneve (Protokolli për Armët e Zjarrit).	70%	80%	90%				
<b>Aktiviteti</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Kostoja totale</b>			<b>Burimi i financimit</b>	<b>Inst. udhëheqës</b>	<b>Inst. mbështetës</b>	<b>Produkti</b>
		<b>Viti 1</b>	<b>Viti 2</b>	<b>Viti 3</b>				
1. Ngritja e grupeve të punës për ndryshimet e ligjeve që ndërlidhen me AVL-të dhe akteve nënligjore përkatës.	TM1-2024 TM2-2025	50 €	50 €	50 €	BRK	MPB	MINT, MD, PK, DK, MMPHI, MM, ZKM, MASHTI, MSH, KPMM,	Vendimi për grupet punuese.



2. Hartimi i analizës nëpërmjet Tabelës së Përputhshmërisë dhe analizës PESTEL.	TM1- 2024 TM2- 2025	50 €	50 €	50 €	BRK	MPB	MINT, MD, PK, DK, MMPHI, MM, ZKM, MASHTI, MSH, KPMM, UNDP, SEESAC, OSBE, HAPE- BE, ICITAP, EXBS	Analiza PESTEL, Tabela e përshtatshmërisë.
3. Plotësim-ndryshimi i ligjeve që ndërlidhen me AVL dhe aktet nënligjore.	TM1- 2024 TM2- 2025	50 €	50 €	50 €	BRK	MPB	MINT, MD, PK, DK, MMPHI, MM, ZKM, MASHTI, MSH, KPMM, UNDP, SEESAC, OSBE, HAPE- BE, ICITAP, EXBS	Miratimi i akteve ligjore dhe akteve nënligjore.
<b>Objektivi specifik 1.2</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>					<b>Baza</b>	<b>Caku 2025</b>	<b>Caku 2026</b>
Të miratohet kuadri ligjor lidhur me AVLE-të për përdorim ushtarak (duke përfshirë ato për çaktivizimin, ruajtjen, prodhimin, shitjen me pakicë, tregtimin, transitin, import-eksportin, shënjimin, gjurmimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen) dhe ato të harmonizohen me	Numri i dokumenteve ligjore për kontrollin e AVLE-së të harmonizuar me legjislacionin e BE-së, Traktatin për Tregtinë e Armëve dhe Protokollin e OKB-së kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Komponentëve dhe Municioneve (Protokolli për Armët e Zjarrit).					70%	90%	95%

Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
		Viti 1	Viti 2	Viti 3				
		1. Ngritja e grupeve të punës për ndryshimin e Ligjit për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri.	TM1- 2024 TM2- 2025	50 €				
